



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**

**Nr.71 , datë 6. 12.2017**

**“PËR**

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN “PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT QENDROR  
TË REGJISTRIMIT DHE SHLYERJES SË TITUJVE (AFISAR)”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c” dhe të nenit 53, pika 4, paragrafi i fundit i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Në rregulloren “Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)”, miratuar me vendimin nr. 76, datë 18.12.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 4, përmbajtja e pikave 26 dhe 47 ndryshon përkatësisht si më poshtë:

*“26. Kontrata tip - është Kontrata e Pjesëmarrjes në AFISaR, sipas shtojcave 1,1/1, 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje, e cila lidhet mes administratorit dhe pjesëmarrësit, për ofrimin e shërbimeve të regjistrimit dhe shlyerjes së transaksioneve me tituj. Në të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese, të cilat rrjedhin nga pozicionet e tyre në sistem në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje”;*

*“47. Profili i pjesëmarrësit - është bashkësia e të dhënave të pjesëmarrësit, të cilat regjistrohen në sistem dhe e identifikojnë atë në mënyrë unike, sipas shtojcave 10, 10/1 dhe 11 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të kësaj rregulloreje”;*

b) Në nenin 4, pas pikës 80 shtohen pikat 81 dhe 82 me përmbajtje përkatësisht si vijon:

*“81. Bursa e Titujve” është një treg i rregulluar për të kryer veprime me tituj në përputhje me licensën që është pajisur”;*

*“82. Sistemi i Bursës së Titujve” është platforma që përdor Bursa e Titujve për të mbështetur realizimin e veprimeve me tituj ndërmjet anëtarëve të saj”.*

- c) Në nenin 15, pika 1, shkronja “a”, shfuqizohet nënparagrafi “vii”;
- d) Në nenin 15, pika 1, pas shkronjës “b”, shtohet paragrafi me shkronjën “c” me përmbajtje si më poshtë:

*“Bursa e Titujve, e cila dërgon instruksione shlyerjeje për llogari të klientëve të saj në sistem nëpërmjet VPN-së. Këtë kapacitet e kanë të gjithë pjesëmarrësit e licensuar nga autoritetet përkatëse”;*

- e) Në nenin 21, shkronja “d” ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

*“Administratori në bashkëpunim me kandidatin, përcaktojnë dhe zbatojnë kalendarin e anëtarësimin si në Shtojcën 12”.*

- f) Në nenin 25, pika 2, shkronja “a” ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

*“të aksesojnë sistemin AFISaR në çdo kohë gjatë ditës së operimit, duke respektuar oraret e tij të punës sipas Shtojcës 7”.*

- g) Pas KREUT IV, shtohet KREU IV/1 me përmbajtje si më poshtë:

***“KREU IV/1  
Bursa e Titujve***

***Neni 26/1  
Bursa e Titujve dhe kushtet për pjesëmarrje***

- 1- *Bursa e Titujve ka akses në sistemin AFISaR nëpërmjet VPN-së. Dërgimi i instruksioneve të shlyerjes realizohet nëpërmjet ndërfaqes AFISaR/Bursë Titujsh. Bursa e Titujve nuk ka llogari vetjake në AFISaR. Bursa ka kapacitetin për të dërguar instruksione vetëm për llogari të anëtarëve të saj.*
- 2- *Bursa e Titujve për të pasur akses në AFISaR duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:*
  - a) *të ketë nënshkruar kontratën tip të pjesëmarrjes në sistemin AFISaR me administratorin sipas Shtojcës 1/1;*
  - b) *të ketë nënshkruar kontratë me anëtarët e saj, me anë të së cilës anëtarët autorizojnë Bursën për të dërguar instruksione shlyerjeje në AFISaR për llogari të tyre ose klientëve të tyre;*
  - c) *të marrë pjesë në sistemin AFISaR vetëm nëpërmjet drejtorisë së saj;*
  - d) *të plotësojë të paktën një nga mënyrat e lidhjes të përcaktuara në nenet 44 dhe 45;*
  - e) *të ketë hartuar rregulla të brendshme operimi për sistemin AFISaR, sipas udhëzimeve të administratorit;*
  - f) *të ketë personel të kualifikuar dhe të trajnuar për operimin në sistemin AFISaR;*

g) të ketë marrë nga administratori certifikatën e pjesëmarrjes në sistemin AFISaR.

### **Neni 26/2**

#### **Procedura për anëtarësimin e Bursës së Titujve**

1- Procedura për anëtarësimin e Bursës së Titujve me të drejtë aksesimi në sistemin AFISaR nëpërmjet VPN dhe ndërfaqes AFISaR/Bursë Titujsh, kalon nëpër këta hapa:

- a) Bursa e Titujve i paraqet administratorit një kërkesë me shkrim për anëtarësimin e tij në sistemin AFISaR, bashkë me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që vërteton licencimin.
- b) Administratori shqyrton kërkesën e kandidatit për anëtarësim dhe i kthen përgjigje brenda 10 (dhjetë) ditësh pune nga data e marrjes së kërkesës;
- c) në rast të miratimit të kërkesës, administratori informon Bursën e Titujve për plotësimin e kushteve të përcaktuara në nenin 26/1, duke i vënë në dispozicion të gjithë bazën rregullative;
- d) administratori në bashkëpunim me kandidatin, përcaktojnë dhe zbatojnë kalendarin e anëtarësimit si në Shtojcën 12;
- e) administratori trajnon përdoruesit e ardhshëm të kandidatit dhe drejton testimin për certifikimin e kandidatit;
- f) pas përfundimit me sukses të provave dhe pasi sigurohet për përputhshmërinë e rregullave të brendshme të kandidatit me këtë rregullore, lëshon një certifikatë për kandidatin si pjesëmarrës në sistemin AFISaR;
- g) kandidati për pjesëmarrës plotëson formularët në Shtojcën 19;
- h) kandidati për pjesëmarrës nënshkruan kontratën tip të pjesëmarrjes në sistemin AFISaR, me administratorin e sistemit, sipas Shtojcës 1/1;
- i) administratori kryen veprimet e tij për VPN, Firewall përgatitjen e certifikatave të sigurisë;
- j) administratori njofton pjesëmarrësin për datën që do t'i jepet akses në sistemin AFISaR të paktën 5 (pesë) ditë punë përpara kësaj date.

### **Neni 26/3**

#### **Detyrimet e Bursës së Titujve në sistemin AFISaR**

1. Bursa e Titujve në sistemin AFISaR është e detyruar të:

- a) zbatojë rregullat dhe procedurat e sistemit AFISaR;
- b) kanalizojë instruksionet në sistemin AFISaR nëpërmjet ndërfaqes, vetëm nga personat e autorizuar;
- c) administrojë sistemet e tij lokale, për të siguruar vazhdimësinë dhe dërgimin e instruksioneve të pagesave në sistemin AFISaR;
- d) sigurojë personel të kualifikuar, të autorizuar për operim në ndërfaqen AFISaR/Bursë Titujsh;
- e) mos lejojë personelin e përkohshëm apo të jashtëm të operojë në ndërfaqen AFISaR/Bursë Titujsh;

- f) njoftojë administratorin në rast të lëvizjes së personelit që ka operuar në ndërfaqen AFISaR/Bursë titujsh, për anulimin e certifikatës së këtij përdoruesi;
- g) hartojë procedura të brendshme për sigurinë dhe për mbrojtjen e sistemit, duke përfshirë procedurat organizative (burimet njerëzore dhe pajisjet) dhe ato informatike (elementet hardware dhe software), në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje;
- h) sigurojë integritetin e transaksioneve dhe akseseve të përdoruesve brenda institucionit duke:
- i) lokalizuar çdo pikë lidhjeje primare apo backup në ndërfaqen AFISaR/Bursë Titujsh, vetëm aty ku ka akses të përshtatshëm për mjetet dixhitale të telekomunikimit, për konfigurimet e duhura të autenticitetit dhe të mjeteve të sigurisë, si dhe të ekzistojë siguria që funksionimi i ndërfaqes AFISaR/Bursë Titujsh nuk do të jetë subjekt i ndërprerjeve apo i ndërhyrjeve të shkaktuara nga faktorët e brendshëm apo të jashtëm;
  - ii) zbatuar parimin “katër sytë” për autorizimin e urdhërpagesës, duke siguruar përdorues të ndryshëm për hedhje të dhënash dhe aprovim të tyre;
  - iii) kryer ekzekutimin e instruksioneve të pagesës, sipas procedurave që respektojnë të drejtat minimale në përputhje me rolin dhe përgjegjësitë e kategorive të ndryshme të personelit
  - iv) kryer vlerësime periodike mujore mbi ngjarjet e paparashikuara në ndërfaqen AFISaR/Bursë Titujsh, sipas Shtojcës 16 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, dhe t`i dërgojnë zyrtarisht pranë administratorit, çdo muaj;
  - v) raportuar çdo muaj janar pranë administratorit për çdo shkelje të vërejtur apo të dyshuar të sigurisë, si dhe të integritetit dhe të qëndrueshmërisë së pajisjeve të tyre të brendshme që lidhen me sistemin AFISaR, sipas Shtojcës 15 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

#### **Neni 26/4**

#### **Kufizimi i përkohshëm dhe përjashtimi i Bursës së Titujve në sistemin AFISaR**

1. Administratori ka të drejtë të kufizojë përkohësisht ose të përjashtojë Bursën e Titujve në sistemin AFISaR.
2. Administratori vendos kufizime mbi pjesëmarrësin në rastet e mëposhtme:
  - a) me njoftim zyrtar të autoritetit përkatës për kufizimin e përkohshëm të licencës për të kryer veprime me titujt për llogari të anëtarëve të tij;
  - b) me kërkesë zyrtare nga autoriteti përkatës licencues ose nga prokuroria/gjykata për kufizimin e përkohshëm të aktivitetit të pjesëmarrësit;
  - c) pjesëmarrësi dështon në plotësimin e qoftë dhe njërit prej kushteve të përcaktuara në nenet 26/1, dhe 26/3;
  - d) kanë filluar procedurat e likuidimit;
  - e) pjesëmarrësi dështon në zbatimin e kësaj rregulloreje në mënyrë të pajustificuar dhe/ose për më shumë se 3 (tre) ditë pune;
  - f) vendosjen e ndonjë embargoje kundrejt shtetit në të cilin ka rezidencën pjesëmarrësi;
  - g) me kërkesë me shkrim të vetë pjesëmarrësit dhe me miratimin e saj nga administratori.

3. *Pjesëmarrësi i kufizuar përkohësisht ka detyrimin të vazhdojë të përmbushë detyrimet e veta financiare dhe jo vetëm, në përputhje me përcaktimet në këtë rregullore.*
4. *Kufizimi i pjesëmarrjes së përkohshme bëhet nëpërmjet kufizimit të ndërfaqes së pjesëmarrësit. Pjesëmarrësi mund të kryejë veprime me këtë ndërfaqe vetëm me aprovim të arsyetuar të autoritetit përkatës.*
5. *Administratori vendos shfuqizimin/revokimin e kufizimit të përkohshëm kur pjesëmarrësi ka përmbushur detyrimet e kërkuara për të përfunduar kufizimin dhe/ose autoritetet përkatëse të cilat kanë marrë vendimin për kufizimin e përkohshëm, njoftojnë për përfundimin e nevojës për kufizim.*
6. *Administratori njofton menjëherë për vendimin për kufizim të përkohshëm të aksesit të pjesëmarrësit ose shfuqizimin/revokimin e këtij vendimi vetë pjesëmarrësin dhe pjesëmarrësit e tjerë.*
7. *Administratori vendos për përjashtimin e Bursës së Titujve nga sistemi AFISaR, kur plotësohet të paktën njëra nga rrethanat e mëposhtme:*
  - a) *me kërkesë me shkrim të vetë pjesëmarrësit, menjëherë pas miratimit nga administratori të kërkesës;*
  - b) *pjesëmarrësi bashkohet/përthithet me/nga një/disa pjesëmarrës të tjerë;*
  - c) *administratorit i komunikohet vendimi për likuidimin/paafhtësinë paguese, apo në rastet kur vendimi për heqjen e licencës nga autoriteti përkatës është përfundimtar dhe i parevokueshëm;*
  - d) *pjesëmarrësi shkel në mënyrë të përsëritur dispozitat e kësaj rregulloreje. Në këtë rast, administratori duhet të sigurohet që pjesëmarrësit i është dhënë mundësia të shprehë mendimin e tij.*
8. *Përpara kryerjes së procedurës së përjashtimit të pjesëmarrësit, administratori sigurohet që nuk ka pagesa në hyrje nga ndërfaqja.*
9. *Në rast se përjashtimi i pjesëmarrësit është i pamundur për shkak të instruksioneve në hyrje nga ndërfaqja, pjesëmarrësi kufizohet përkohësisht, deri sa të kryhen procedurat për transferimin e këtyre instruksioneve.*
10. *Administratori njofton menjëherë për vendimin për përjashtimin e pjesëmarrësit, vetë pjesëmarrësin dhe pjesëmarrësit e tjerë.*
11. *Administratori ndalon operimin e ndërfaqes së pjesëmarrësit të përjashtuar. Të dhënat historike për këtë pjesëmarrës mbeten në databazë.*
12. *Pjesëmarrësi është i detyruar të paguajë të gjitha detyrimet ndaj administratorit për pjesëmarrjen në sistem, që kanë lindur përpara vendimit për përjashtimin e tij.*

13. *Administratori kryen procedurat e përcaktuara për ndërprerjen e lidhjes me pjesëmarrësin duke çaktivizuar certifikatën.*

h) Neni 44 ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

1. *Aksesi për komunikimin nëpërmjet VPN-së do t'i jepet vetëm pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë dhe Bursës së Titujve, që kanë të drejtë për këtë mënyrë komunikimi, sipas përcaktimeve në rregulloren për "Sigurinë e Informacionit" të Bankës së Shqipërisë.*
2. *Pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë që komunikojnë nëpërmjet VPN-së, do të kenë mundësi të aksesojnë sistemin nëpërmjet workstation-it. Ky akses u jep mundësi:*
  - a) *të iniciojnë udhëzimet për të debituar/kredituar llogarinë e tyre ose të klientëve të tyre. Udhëzimet kryhen nga workstation-i, duke dërguar mesazhe të përcaktuara sipas tipit të transaksionit në Shtojcën 6;*
  - b) *të monitorojnë statusin e transaksionit të tyre, duke lexuar statutet e përshkruara në Shtojcën 6;*
  - c) *të monitorojnë llogarinë e tyre dhe të klientëve të tyre;*
  - d) *të monitorojnë ngjarjet që lidhen me titujt, siç janë pagesat e kuponave dhe maturimet;*
  - e) *të realizojnë pjesëmarrjen në ankand primar për llogari të tyre dhe të klientëve të tyre;*
  - f) *të marrin të gjithë informacionin që lidhet me rezultatin e pjesëmarrjes në ankandin primar;*
  - g) *të monitorojnë përdorimin e sistemit nga përdoruesit e tyre.*
3. *Bursa e Titujve që komunikon nëpërmjet VPN-së, do ketë mundësi të aksesojë sistemin nëpërmjet ndërfaqes elektronike. Ky akses i jep mundësi:*
  - a) *të iniciojë udhëzimet për të debituar/kredituar llogaritë e anëtarëve të saj;*
  - b) *të marrë informacione mbi statusin e transaksioneve.*

i) Në nenin 50, pika 4, shkronja "b" ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

*"Komision mirëmbajtjeje"*

j) Në nenin 55, pika 1 ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

*"Orari i punës së sistemit AFISaR është i përcaktuar në Shtojcën 7, por administratori ka të drejtë t'i modifikojë edhe gjatë ditës së punës, për të ruajtur mbarëvajtjen e sistemit".*

k) Pas Shtojcës 1, shtohet Shtojca 1/1 me titull "Kontrata tip për pjesëmarrjen e Bursës së Titujve", bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

- l) Përmbajtja e Shtojcës 4 me titull “Kontrata për shlyerjen e transaksioneve në *cash* që gjenerohen nga veprimet me tituj të personave fizikë që e kanë llogarinë e titullit në Bankën e Shqipërisë” ndryshon sipas Shtojcës 4 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
  - m) Përmbajtja e Shtojcës 8 me titull “Komisionet e aplikuara në sistemin AFISaR” ndryshon sipas Shtojcës 8 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
  - n) Pas Shtojcës 10, shtohet Shtojca 10/1 me titull “Informacion mbi Bursën e Titujve” bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
  - o) Përmbajtja e Shtojcës 12 ndryshon sipas përmbajtjes së Shtojcës 12 me titull “Anëtarësimi në AFISaR i një pjesëmarrësi të drejtpërdrejtë dhe Bursës së Titujve” bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të autorizojë Drejtorin e Departamentit të Operacioneve Monetare të nënshkruajë kontratën tip për pjesëmarrjen e Bursës së Titujve në sistemin AFISaR, sipas përmbajtjes së Shtojcës 1/1 dhe kontratën tip për shlyerjen e transaksioneve në *cash* që gjenerohen nga veprimet me tituj të personave fizikë që e kanë llogarinë e titullit në Bankën e Shqipërisë, sipas përmbajtjes së Shtojcës 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
  3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në Bankën e Shqipërisë, si dhe pjesëmarrësit e sistemit AFISaR.
  4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**Elvis ÇIBUKU**

**Gent SEJKO**